

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **SHSKUK - SHËRBIMI SPITALOR KLINIK UNIVERZITARE I KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr i Prokurimit	220-26-4448-1-1-1
Nr i brendshëm	220-26-045-1-1-1

Sa i përket tenderit për: **“Furnizim me material nga LE për Kardiologji Invazive për nevojat e SHSKUK-së”-LOT 15.**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

SOLUTION D MEDICAL SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.Kasëm Haxhimurati, nr.60

(Adresa)

Prishtine

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

038 233 233

038603524

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Driton Sanaja

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

sales@solutiond.net

(Adresa elektronike)

03.092026

(Data e parashtrimit të ankesës)



(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për Kontratë: 08.06.2026
Hapja e hapjes ofertave: 02.07.2026
Njoftimi mbi vendimin e AK-së: 21.08.2026
Kërkesës për Rishqyrtim e dt.26.08.2026
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim: 28.08.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së
Neni 6 i LPP-së
Neni 7 i LPP-së
Neni 52 i LPP-së
Neni 59 i LPP-së
Neni 60 i LPP-së
Neni 69 i LPP-së
Neni 40 i Rregullores nr.001/2022 për Prokurim Publik

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Të nderuar ne me dt.21.08.2026 përmes platformës elektronike e-prokurimi kemi pranuar njoftimin mbi vendimin e AK-së ku për lot 15 është rekomanduar për kontratë **OE Medical Group SH.P.K.**, kurse ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

AK-SHSKUK për Lot 15 në ankesin 1 të dosjen e tenderit ka kërkuar produktin më këto specifika: "Mikrokateter koronar me veshje hidrofilike, gjatësia: ≥ 110 cm Diametri distal: 1.5–3.0 Fr. Veshje distal hidrofilike: ≥ 20 cm. Maja atraumatike, me marker radiopak 3–5 mm. Struktura shtresë PTFE brendshme + gërshetë çeliku inox + shtresë polimerike e jashtme. Porti OTW (over-the-wire) Kompatibilitet me tela guidewire 0.014" dhe kateter udhëzues 5F/6F+ Performanca siguron trackability të mirë dhe manovrim të kontrolluar në anatomi të tortuozuar."

Ju si OE keni prezantuar moster e cila nuk i përmbushë specifikat e kërkuara sipas ankesit 1 të dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë, është kërkuar markeri radiopak i kërkuar 3-5 mm, është sjellur për vlerësim mostra me marker radiopak 1 mm.

Lidhur me eliminimin tonë për Lot 15, dëshirojmë të theksojmë se para dorëzimit të ofertave kemi kërkuar sqarim shtesë nga Autoriteti Kontraktues lidhur me kërkesën për markerin radiopak të mikrokateterit.

Në kërkesën për sqarim kemi pyetur konkretisht nëse ***mund të ofrohej mikrokateteri me marker radiopak prej 0.7 mm, të pozicionuar 0.7 mm nga maja (tipi), duke ofruar vizibilitet të përmirësuar gjatë procedurës.***

Për këtë pyetje, autoriteti kontraktues është përgjigjur qartë: ***"Po, mund të ofrohet mikrokateteri me karakteristikat e sipërpërmendura".***

Shih pyetjen tonë dhe përgjigjen nga autoriteti kontraktues:

Të nderuar,

Në bazë të specifikimit teknik, ju lutemi të na sqaroni sa vijon:

Artikulli me numër rendor 15: A mund të ofrohet ofertimi i mikrokateteri me karakteristika teknike më të avancuara, i pajisur me marker radiopak prej ari (Gold) me gjatësi 0.7 mm, të pozicionuar 0.7 mm nga maja (tipi), duke ofruar vizibilitet të përmirësuar gjatë procedurës?

Përgjigja nga njësia e kërkesës:

Po, mund të ofrohet mikrokateteri me karakteristikat e sipërpërmendura

Duke u bazuar në këtë përgjigje të AK-së e cila gjendet në platformën e E-Prokurimit, ne kemi përgatitur dhe dorëzuar ofertën duke u mbështetur në sqarimin e dhënë nga vet autoriteti kontraktues para afatit të dorëzimit të ofertave.

Mirëpo edhe përkundër këtij fakti ne në njoftimin mbi vendimin e AK-së jemi eliminuar me arsyetimin se kemi dorëzuar mostrën në kundërshtim me kërkesën për marker radiopak 3–5 mm.

Në këtë rast kemi të bëjmë me mos respektim të përgjigjeve të dhëna nga vet autoriteti kontraktues para dorëzimit të ofertave. Pra edhe një herë po e sqarojmë se ne kemi kërkuar paraprakisht leje për një konfigurim të ndryshëm të markerit radiopak dhe kemi marrë përgjigje pozitive nga autoriteti kontraktues, ku na është lejuar ofertimi me mostrën me të cilën kemi ofertuar, prandaj sqarojmë se mostra dhe oferta jonë duhet të shqyrtohen edhe një herë duke i marr parasysh të gjitha sqarimet e dhëna nga autoriteti kontraktues para dorëzimit të ofertave.

Përveç faktit se autoriteti kontraktues, para afatit të dorëzimit të ofertave, na ka konfirmuar shprehimisht se mund të ofrohet mikrokateteri me marker radiopak prej 0.7 mm, të pozicionuar 0.7 mm nga maja (tipi), duam të sqarojmë edhe një gjë tjetër me rëndësi lidhur me mënyrën se si është vlerësuar mostra jonë. Në mostrën fizike të dorëzuar nga ana jonë nuk figuron askund ndonjë shënim, dimension apo specifikim teknik nga i cili mund të konstatohet se markeri radiopak i dorëzuar nga ne është 1 mm. Për këtë arsye, për ne si OE i përgjegjshëm nuk është e qartë se mbi çfarë baze AK-ja ka ardhur në përfundimin se mostra jonë ka marker radiopak prej 1 mm.

Nëse AK-ja e ka nxjerrë këtë përfundim duke interpretuar shënimin e paraqitur në paketimin e produktit, atëherë konsiderojmë se në këtë rast bëhet fjalë për një interpretim të gabuar të informacionit të paketimit. Shënimi në paketim, ku paraqitet numri “1” së bashku me shënimin “RO Marker”, nuk duhet të merret si dëshmi se diametri i markerit radiopak është 1 mm, sepse numri “1” nuk paraqet një specifikim të diametrit të markerit në milimetra dhe në asnjë pjesë të mostrës së dorëzuar, nuk ekziston shënimi “1 mm” që do të mund të shërbente si bazë për një konstatim të tillë, mirëpo nënkupton që në këtë mikrokater gjindet vetëm një marker radiopak, pra sasia se sa janë të vendosura në paketim.

Për ta sqaruar edhe më qartë gjendjen faktike ne më poshtë po i bashkangjesim të gjitha fotografitë e paketimit, ku ne dyshojmë që ka mund të ndodhë ndonjë lëshim teknik nga ana e AK-së dhe i janë referuar gabimisht përshkrimeve të cilat janë vendosur në paketim:

TERUMO

CONFIDENTIAL

**Packaging and labeling Finecross MG
(Manufactured by TC)**

Individual package label

TERUMO
FINECROSS™ MG
Coronary Micro-Guide catheter

1.8Fr. (0.60mm) 2.6Fr. (0.87mm)

Hydrophilic Coating Length
70cm
<L> 130cm

MD CE 2797
STERILE EO

1
RO Marker

↓ Max Guide Wire O.D.
0.014" (0.36mm)

REF コード番号 NC-F863A
LOT 製造番号 YYMMDD

製造年月日 YYYY-MM-DD
使用期限 YYYY-MM-DD

TERUMO CORPORATION
4-1, 2-CHOME, HATAKOTA, SHIBUYA-KU, TOKYO 157-8522, JAPAN MADE IN JAPAN


Ashitaka Factory of Terumo Corporation
150, Maizumi-cho, Fujinomiya City, Shizuoka Prefecture, 418-0015, Japan

UDI
001304987350676733<17>YYMMDD<10>YYMMDD

EQ REP TERUMO EUROPE N.V.
INTERLEUWENLAAN 40, 3001 LEUVEN, BELGIUM

Contents / 入り数 1

Unit box label

FINECROSS MG REF NC-F863A LOT YYMMDD	FINECROSS MG REF NC-F863A LOT YYMMDD	FINECROSS MG REF NC-F863A LOT YYMMDD	FINECROSS MG REF NC-F863A LOT YYMMDD UDI  (01)04987350676733(17)YYMMDD(10)YYMMDD
1.8Fr. (0.60mm) 2.6Fr. (0.87mm)			
			
 0.014" (0.36mm)		保険医療材料請求分類: 冠動脈狭窄部貫通用カテーテル  Contents / 入り数	
REF コード番号 NC-F863A LOT 製造番号 YYMMDD		製造年月日 YYYY-MM-DD 使用期限 YYYY-MM-DD Use by date	
Ø 1.8Fr. <L> 130cm			

Individual package





Do not reuse



Do not reuse if package is damaged and consult instructions for use



Consult instructions for use



Do not sterilize

開封した直後の内容を確認の上、使用すること。

- 水ぬれに注意し、面材目丈及び高圧多湿を避けて保管すること。
- 使用は一袋限りとする。
- エアレンオキサイドガス滅菌済み

高度医療医療機器 再使用禁止 一時的な使用：冠動脈狭窄部貫通用カテーテル
 製造元：マビウス 製造場所：東京都中央区 2-1-1 300
 製造年月日：2017年10月1日 有効期限：2020年10月1日
 製造元：マビウス 製造場所：東京都中央区 2-1-1 300

Shipping carton label



TERUMO

MD CE 2797

FINECROSS MG
Coronary Micro-Guide catheter

5
Contents / 内容

REF コード番号 NC-F863A
LOT 製造番号 YYMMDD
製造年月日 YYYY-MM-DD
使用期限 YYYY-MM-DD
Use by date

UDI



(01)54987350676738(17)YYMMDD(10)YYMMDD

TERUMO CORPORATION
461, NICHINO, HIRAKAWA, NAGANO 380-0101, JAPAN
TERUMO EUROPE N.V.
NEDERLANDSE LAAN 101, 1013 XG, AMSTERDAM

MADE IN JAPAN

高度先端医療機器 再使用禁止 一般の名称：冠動脈貫通用カテーテル
販売名：ナビキャス 医療機器承認番号：21300BZZ00321000
製造販売業者：テルモ株式会社 東京都渋谷区幡ヶ谷2丁目44番1号



TERUMO

MD CE 2797

FINECROSS MG
Coronary Micro-Guide catheter

5
Contents / 内容

REF コード番号 NC-F863A
LOT 製造番号 YYMMDD
製造年月日 YYYY-MM-DD
使用期限 YYYY-MM-DD
Use by date

UDI



(01)54987350676738(17)YYMMDD(10)YYMMDD

TERUMO CORPORATION
461, NICHINO, HIRAKAWA, NAGANO 380-0101, JAPAN
TERUMO EUROPE N.V.
NEDERLANDSE LAAN 101, 1013 XG, AMSTERDAM

MADE IN JAPAN

高度先端医療機器 再使用禁止 一般の名称：冠動脈貫通用カテーテル
販売名：ナビキャス 医療機器承認番号：21300BZZ00321000
製造販売業者：テルモ株式会社 東京都渋谷区幡ヶ谷2丁目44番1号

Detail of the descriptions on the individual packaging



Do not reuse



Do not use if package
is damaged and
consult instructions
for use



Consult instructions
for use



Do not resterilize

■電子添文の内容を確認の上、使用すること。

- 水ぬれに注意し、直射日光及び高温多湿を避けて保管すること。
- 使用は一回限りとすること
- エチレンオキサイドガス滅菌済み


高度管理医療機器 再使用禁止 一般的名称：冠動脈貫通カテーテル

販売名：ナビキャス 医療機器承認番号：21300BZZ00321000


製造販売業者：テルモ株式会社 東京都渋谷区幡ヶ谷2丁目44番1号

記載されている社名、各種名称は、テルモ株式会社および各社の商標または登録商標です。


Unit box



Enlarged image Unit box - 1



Nëse eventualisht AK-ja ka ardhur në përfundimin se mostra jonë ka marker radiopak 1 mm vetëm duke interpretuar numrin "1" të paraqitur në **paketim (shih më poshtë fotografinë)**, ky përfundim nuk mbështetet në ndonjë specifikim teknik të produktit dhe është në kundërshtim me dokumentacionin teknik të dorëzuar nga ana jonë, prandaj sqarojmë se konstatime të tilla duke mos i analizuar dokumentet e prezantuara nga ne dhe mostrën e dorëzuar, janë krejtësisht të pa bazuara dhe të pa mbështetura në dispozita ligjore, për më tepër po eliminohe mi ne si OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë se sa OE i rekomanduar për kontratë.



RO Marker

Për më tepër, sqarojmë se ne kemi dorëzuar edhe katalogun teknik të produktit, ku paraqiten në mënyrë të qartë specifikimet konkrete të mikrokaterit të ofruar. Në këtë dokument specifikohet qartë se produkti ka "0.7 mm gold marker located 0.7 mm from the tip", ndërsa në dokumentin e prodhuesit/Terumo-s specifikohet gjithashtu "0.7 mm gold marker on the distal tip". Pra, dokumentacioni teknik i dorëzuar së bashku me ofertë e identifikon qartë karakteristikën e markerit radiopak ku figurojnë qartë specifikat e produktit të ofertuar, ashtu siç ka lejuar autoriteti kontraktues ofertimin.

Shih fotografinë nga katalogu:

Finecross® MG microcatheter represents the integration of superior crossability and optimal guidewire support to treat very challenging cases, involving tortuous vessels, CTO, bifurcations, highly stenosed and calcified lesions.

ACHIEVE A SUPERIOR CROSSABILITY

- Hydrophilic coating and flexible distal segment to enable advancement and access through distal tortuous vessels.
- Tapered inner and outer diameters, from 2.6 Fr to 1.8 Fr over the entire length for greater lesion crossability.

PRODUCT SPECIFICATIONS

2.6 Fr (0.87 mm)
1.8 Fr (0.61 mm)
0.7 mm
Distal Technology Hydrophilic coating (on distal portion)
Distal tip
0.7 mm (distal tip)
0.7 mm (distal tip)

Distal segment: Hydrophilic coating
Braid: Stainless steel - SUS
Inner core: Polytetrafluoroethylene - PTFE
Outer sheath: 1.8 Fr (0.61 mm)
Radiopaque marker: 0.7 mm gold marker located at 0.7 mm from the tip

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se arsyeja e eliminimit tonë për Lot 15 është e paqëndrueshme, prandaj kërkojmë rishqyrtimin e vendimit të AK-së dhe gjatë rishqyrtimit kërkojmë të merret parasysh përgjigjja zyrtare e autoritetit kontraktues, me të cilën është konfirmuar se mikrokateri me karakteristikat e kërkuara në sqarimin tonë mund të ofrohet.

Ne pajtohem me arsyet e AK-së për eliminimin e **OE AGS Corporation SH.P.K.**, prandaj për ti mos përsëritur edhe një herë të gjitha pretendimet tona ankimore, vetëm po e bashkangjesim arsyetimin e AK-së të cilin e ka dhënë tek njoftimi mbi vendimin e saj:

AK-SHSKUK për Lot 15 në ankesin 1 të dosjen e tenderit ka kërkuar produktin më këto specifika: "Mikrokateter koronar me veshje hidrofilike, gjatësia: ≥ 110 cm Diametri distal: 1.5–3.0 Fr. Veshje distal hidrofilike: ≥ 20 cm. Maja atraumatike, me marker radiopak 3–5 mm. Struktura shtresë PTFE brendshme + gërshetë çeliku inox + shtresë polimerike e jashtme. Porti OTW (over-the-wire) Kompatibilitet me tela guidewire 0.014" dhe kateter udhëzues 5F/6F+ Performanca siguron trackability të mirë dhe manovrim të kontrolluar në anatomi të tortuozuar."

Ju si OE keni prezantuar moster e cila nuk i përmbushë specifikat e kërkuara sipas ankesit 1 të dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë, është kërkuar mikrokatheter koronar, me veshje hidrofilike, është sjellur për testim kateter aspirativ.

AK-SHSKUK për Lot 26 në ankesin 1 të dosjen e tenderit ka kërkuar produktin më këto specifika: Tub lidhës për presion të lartë (high-pressure extension/monitoring line) për angiografi koronare, kompatibel me manifold dhe sistem injektimi kontrasti, me rezistencë ≥ 300 PSI (preferohet deri 1200 PSI), me lidhje Luer lock, gjatësi 100–150 cm (ose 25–200 cm), steril, njëpërdorimshëm, latex-free, ose ekuivalent.

Ju si OE keni prezantuar moster e cila nuk i përmbushë specifikat e kërkuara sipas ankesit 1 të dosjes se tenderit dhe njoftimit për kontratë, është kërkuar kateter për trombektomi mekanike, është sjellur për testim microcatheter.

Ne me dt.28.08.2026 kemi pranuar vendimin mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim, ku AK-ja e ka cilësuar të njëjtën si të pa bazuar, por që nuk ka dhënë asnjë fakt konkret dhe të bazuar në dispozita ligjore për një refuzim të tillë.

Në përgjigjen e saj AK-ja e refuzon kërkesën në tërësi si të pabazuar, duke u mbështetur vetëm në faktin se dosja e tenderit ka kërkuar mikrokateter me marker radiopak 3–5 mm, dhe se komisioni profesional i Klinikës së Kardiologjisë – QKUK ka konstatuar se mostra e dorëzuar nga OE-ja ka marker radiopak 1 mm, pra jokonform. Ky arsyetim është përsëritje e arsytimit të cilin e njëjta e ka specifikuar tek njoftimi mbi vendimi i saj. I njëjti arsyetim është i paqëndrueshëm për faktin se i njëjti injoron tërësisht dy fakte vendimtare të paraqitura nga ne në kërkesën për rishqyrtim.

Fillimisht edhe një herë po e sqarojmë qartë se AK-ja vetë, para afatit të dorëzimit të ofertave dhe përmes platformës së e-Prokurimit, **ishte pyetur shprehimisht nëse mund të ofrohej mikrokatheteri me marker radiopak 0.7 mm, i pozicionuar 0.7 mm nga maja, dhe ishte përgjigjur qartë "Po, mund të ofrohet mikrokatheteri me karakteristikat e sipërpërmendura"**. Njëkohësisht ne e kemi cekur qartë se askund mbi mostrën fizike apo paketimin e saj nuk figuron ndonjë shenjë "1 mm". Autoriteti kontraktues nga arsyetimet e saj kuptohet se i është referuar numrit 1 i cili gjendet në paketimin e produktit, por ne po e sqarojmë se numri "1" i shënuar në paketim nuk përfaqëson një specifikim diametri.

Shënimi në paketim, ku paraqitet numri "1" së bashku me shënimin "RO Marker", nënkupton që në këtë mikrokatheter gjendet vetëm një marker radiopak, pra sasia se sa janë të vendosura në paketim.

Pra fotoja e mëposhtme tregon sasinë e produkteve që gjenden në paketim dhe jo milimetrat e produktit.



RO Marker

Përgjigjja e AK-së nuk e mohon, nuk e komenton dhe as nuk e vë në pikëpyetje asnjërin prej këtyre dy fakteve, thjesht i injoron, pa ndonjë arsyetim në lidhje me pretendimin tonë.

Kur kemi parasysh këto fakte kuptohet qartë se vendimi i AK-së bie ndesh me sqarimin zyrtar që AK-ja vetë e ka dhënë. AK-ja në asnjë mënyrë nuk mund dhe nuk duhet të na eliminoj nga aktiviteti i prokurimit për kinse mospërputhje me specifikimin fillestar prej 3–5 mm, kur vetë AK-ja, me shkrim dhe para afatit të dorëzimit, e kishte lejuar shprehimisht konfigurimin me marker 0.7 mm. Sqarimet zyrtare të dhëna gjatë procesit të tenderimit bëhen pjesë përbërëse e kushteve mbi bazën e të cilave OE përgatit ofertën, dhe refuzimi i mëvonshëm i ofertës për t'iu përmbajtur asaj që vetë AK-ja e ka lejuar, përbën veprim në kundërshtim me sjelljen e vet dhe shkelje të parimit të mirëbesimit dhe të sigurisë juridike. Njëkohësisht,

përgjigjja e AK-së është e paarsyetuar dhe jo profesionale sepse një përgjigje që kufizohet në përsëritjen e arsyes fillestare të eliminimit, pa iu përgjigjur asnjërit prej pretendimeve të parashtruara në kërkesë për rishqyrtim, në veçanti pa komentuar fare sqarimin paraprak të vet AK-së, element që ndryshon tërësisht vlerësimin e rastit nuk përbën arsyetim të mjaftueshëm dhe e bën vendimin arbitrar.

Vetë arsyetimi i AK-së, në fakt, e vërteton faktin se konstatimi për "marker 1 mm" është bazuar ekskluzivisht në leximin e paketimit dhe jo në ndonjë matje apo dokumentacion teknik. Përgjigjja e AK-së nuk përmend asnjë raport laboratorik, asnjë matje fizike, asnjë specifikim teknik apo referencë të dokumentacioni i prodhuesit që të mbështesë shifrën "1 mm", pra i vetmi burim i mundshëm i kësaj shifre në tërë ofertën tonë është numri "1" i shënuar në paketimin e produktit. Duke mos cituar asnjë bazë tjetër, AK-ja në fakt konfirmon vetë se komisioni e ka nxjerrë këtë konkluzion thjesht duke interpretuar atë shenjë paketimi, pa e konfrontuar këtë interpretim me dokumentacionin teknik zyrtar të prodhuesit të bashkëngjitur ofertës, i cili tregon qartë 0.7 mm.

Kur kemi parasysh të gjitha faktet e lartcekura, kuptohet qartë se AK-ja na ka eliminuar padrejtësisht nga ky aktivitet i prokurimit edhe përkundër faktit që ne jemi OE i përgjegjshëm dhe me çmim më të lirë. Kërkojmë nga eksperti shqyrtues dhe paneli shqyrtues i OSHP-së që ti analizojnë në detaje pretendimet tona ankimore dhe nëse eventualisht gjatë shqyrtimit hasni në ndonjë dilemë, atëherë mund të kërkonit sqarime në lidhje me këtë çështje dhe ne do ti ofrojmë të gjitha sqarimet e nevojshme, me qëllim që të respektohen dispozitat ligjore, sqarimet para dorëzimit të ofertave dhe kërkesat e dosjes së tenderit.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është bërë ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve në harmoni me nenin 59 të LPP-së, përkritazi me ofertën tonë, prandaj duhet rishqyrtuar edhe njëherë ky aktivitet i prokurimit me të gjitha dëshmitë e ofruara, sepse ne jemi OE i përgjegjshëm dhe nuk është dashur të eliminohemi nga konkurrenca.

Gjithashtu nuk është respektuar edhe kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë **tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët** siç parashihet edhe në nenin 60 paragrafi 1.1 i LPP-se sepse është rekomanduar për kontratë operatori ekonomik me çmim më të shtrenjtë, ndërsa ne si OE i përgjegjshëm me çmim më të ulët nuk jemi rekomanduar për kontratë.

Në këtë aktivitet të prokurimit nuk është respektuar edhe neni 7 i LPP-së, sepse jemi diskriminuar ne si operatori ekonomik i përgjegjshëm duke u eliminuar nga aktiviteti i prokurimit edhe pse i kemi plotësuar të gjitha kërkesat e FDT-së, specifikimet teknike të detyrueshme dhe kërkesat e njoftimit për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që *"Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo-diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Po ashtu paragrafi 6 i nenit 7 të LPP-së e parasheh që gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë; që (vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtjesore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse"*, mirëpo në këtë rast AK-ja nuk i është përmbajtur as kësaj dispozite ligjore sepse oferta e OE të rekomanduar për kontratë nuk i plotëson të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit, sepse është ofertë me çmim më të shtrenjtë se sa oferta jonë.

Gjithashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Duke u bazuar në të gjitha dëshmitë dhe faktet që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP që të merr:

VENDIM

APROVOHET ankesa e OE **SOLUTION D MEDICAL SH.P.K.**, për LOT 15 si e bazuar,

ANULOHET njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për **LOT 15** dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM**,

DETYROHET autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

Nëse nuk merren parasysh faktet tona, ne jemi të detyruar të vazhdojmë procedurën ligjore në institucionet tjera kompetente.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim, ankesën etj. në vlerë prej 5,000.00 euro.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe
- g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.